

Editorial

Le të flasim për statusin hapësinor të Kosovës!

Me marrjen e vendimeve politike lidhur me ardhmërinë e Kosovës ka ardhur koha për t'u marrë më seriozisht me statusin fizik dhe social të kësaj pjese të Ballkanit. "Më seriozisht" do të thotë se **zhvillimi i qëndrueshëm** duhet të jetë në buzët e secilit si dhe në mendjet e secilit. Kosovës i nevojitet zhvillimi dhe ai duhet të jetë i qëndrueshëm në aspektin e zhvillimit ekonomik, mirëqenies shoqërore dhe mirëqenies dhe së fundi, po jo më pak e rëndësishme i padëmshëm për mjesdisin. Dhe për të qenë i qartë, kjo është e kundërta e trendit aktual; me fjalë tjera, ne duhet ta ndërpresim trendin e zhvillimit të paqëndrueshëm të dekadave të kaluara dhe veçanërisht të viteve pas luftës.

Mënyra se si ne e organizojmë hapësirën e kufizuar të Kosovës—ajo që e quajmë planifikim hapësinor—është tejet e rëndësishme për këtë qëllim; mënyra si ne i organizojmë dhe i menaxhojmë qytetet në rritje të Kosovës—ajo që e quajmë planifikim urban është poaq e rëndësishme, pasi gjithnjë e më shumë njerëz dëshirojnë të jetojnë në qytete dhe Prishtina vazhdon të jetë magnet për shumë syresh. UN-HABITAT-i e përkrah këtë sfidë të madhe të **zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor dhe urban në Kosovë**. Por, ndryshimet pozitive mund të arrihen vetëm nëse palët e interesuara të nivelit qendror dhe atij lokal të Kosovës janë të zotuara dhe të përkushtuara ndaj këtij qëllimi. Po ashtu, kjo kërkon aleanca dhe partneritete të fuqishme ndërmjet autoriteteve publike, sektorit privat, shoqërisë civile dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Programi i përkrahjes së komunave për planifikimin hapësinor (MuSPP), i cili e përkrah planifikimin hapësinor në 6 qytete sekondare në Kosovë, mund të konsiderohet si "nxemje" para maratonsë së zhvillimit të qëndrueshëm urban. Me përkrahjen e Sida-s, UN-HABITAT-i ka përgatitur një program sfidues për ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve me

Na i dërgoni idetë e juaja se si t'i bëjmë qytetet e Kosovës më të mira për të jetuar, punuar, lëvizur dhe për të shprehur vetveten

info@unhabitat-kosovo.org

ekipe ekspertësh me bazë në komuna. Ne kemi promovuar një "qasje të të mësuarit duke i bërë gjërat" të cilën e kemi aplikuar edhe ndaj vetes. Fokusi ka qenë dhe vazhdon të jetë kryesisht në hartimin e planeve Zhvillimore Komunale dhe Urbane, por ne po ashtu, kemi filluar përdorimin e mjeteve të reja si vizionimi pjesëmarrës dhe çështjet e "reja" si lëvizshmëria e qëndrueshme urbane dhe "krijimi i hapësirave". Po ashtu, ne kemi përkrahur fuqimisht një qasje inovative drejt sfidës së Vendbanimeve Joformale në Kosovë dhe së fundi, po jo më pak e rëndësishme, ne kemi nisur shtatë projekte urbane të vogla për ta demonstruar në praktikë planifikimin urban. Është shumë herët për të bërë ndonjë vlerësim, por ka pasur indikacione nga sponsori ynë suedez, Sida, se e ka për qëllim të vazhdojë përkrahjen e kësaj qasjeje inovative dhe ne jemi në pritje të kësaj.

Në këtë numër vëmendja është vënë në **hapësirën publike dhe dizajnin urban**, me praktikën në Mitrovicë (jug dhe veri), Gjakovë dhe Ferizaj. Shpesh këto praktika janë të rrënjosura në fushën e transportit dhe lëvizshmërisë dhe kjo tregon se dizajni urban i hapësirave publike mund t'i afrojë "botërat e kundërta" të planifikimit hapësinor dhe transportit. Afrimi i këtyre botërave ka qenë, po ashtu, qëllimi i Konferencës së Parë për Transportin dhe Planifikimin Hapësinor në Kosovë, e organizuar bashkarisht nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me përkrahjen e MuSPP. Konferenca mëtonte të bashkonte përvojën kosovare dhe atë ndërkombëtare

dhe të promovojë rolin e transportit publik në zhvillimin e qëndrueshëm urban në Kosovë. Gjithashtu, Punëtorja mbarë kosovare për Vendbanimet Joformale ka treguar gatishmërinë e shumë palëve të interesuara, MMPH, OSBE, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe UN-HABITAT-it për një qasje shumëdisiplinare dhe përfshirëse, të shënuara "përmendësh" ndaj këtyre vendbanimeve si komunitete të gjalla dhe të banueshme. Numri i madh i pjesëmarrësve në këto takime dëshmon se sa të rëndësishme janë këto çështje për ditët e sotshme të Kosovës dhe për ardhmërinë e saj.

Ju, po ashtu, do të lexoni për një takim tjetër trepalësh. Përkundër kënaqësisë së përgjithshme të partnerëve dhe donatorëve me progresin e bërë deri më tani, mbetet edhe shumë punë për t'u bërë, veçmas sa i përket Planeve për Zhvillimin Komunal dhe Urban. Prandaj, ne kemi nevojë për zotimin e plotë të partnerëve tonë lokalë për të realizuar drejtimit tona të përbashkëta drejt miratimit të këtyre dokumenteve të rëndësishme planifikimi. Ne llogarisim në vazhdimin e përpjekjeve për t'i pasur shumicën e planeve gati deri në fund të MuSPP1 (fundi i Prillit), ashtu që të mund të nisim të gjithë bashkarisht fazën e ardhshme të maratonit të zbatimit, monitorimit, vlerësimit, revidimit, zhvillimit të projektit ... me pak fjalë "ciklin e pafund të planifikimit" me rezultatet të dukshme për qytetarët dhe me pjesëmarrjen e tyre.

Frank D'hondt

Koordinator për planifikimin hapësinor MuSPP1

NEVOJA PËR DIZAJN URBAN NË KOSOVË

Karta e Lajpcigut për qytete të qëndrueshme evropiane (maj 2007), e konsideron se "krijimi dhe sigurimi i hapësirave të cilësisë së lartë... është me rëndësi thelbësore për forcimin e konkurrueshmërisë së qyteteve evropiane".

Ky artikull e analizon këtë deklaratë nga perspektiva e Kosovës, pasi që edhe këtu është po aq i vlefshëm sa edhe në çdo vend tjetër në Evropë si dhe çka nënkupton ai. Viteve të fundit ka pasur një shtim të shpejtë të popullsisë në qytetet dhe fshatrat e Kosovës, e në radhë të parë në Prishtinë, popullsia e të cilës që nga përfundimi i konfliktit është dyfishuar. Ndryshimi fizik ka shkuar paralelisht me përmbymbjen sociale pasi që traditat e klanit dhe familjes janë përfshirë në urbanizim dhe infrastruktura (rrugët, hapësirat publike dhe shkollat si dhe uji, kanalizimi dhe energjia elektrike, etj) përpiket që t'iu përgjigjet kërkesave gjithnjë e më të mëdha të një numri gjithnjë e më të madh të njerëzve. Këto kërkesa dhe pritje janë duke e nxitur konkurrencën për hapësirë në qytet, me një dëshirë që të mundësojë mobilitetin e personal dhe janë lartë në agjendë për shumicën e vendimmarrësve. Ndoshta një ndër shprehjet kryesore të kësaj gjendjeje janë rrugët e Prishtinës dhe të qyteteve të tjera në Kosovë, të cilat janë të bllokuara nga trafiku, i cili e zë pothuaj tërë hapësirën nga njëri mur i ndërtesës në njërin anë të rrugës deri te muri tjetër në anën tjetër. Me trotuare të dobëta për këmbësorë, të cilët janë me gropa, të bllokuar nga automjetet e parkuara dhe me shumë pak hapësirë, ato e dekurajojnë çfarëdo shfrytëzimi tjetër përveç vozitjes së automjeteve nëpër to.

Ky është problemi kryesor kur kihet parasysh se rrugët dhe hapësirat publike e përbëjnë rreth 20% të shumicës së qyteteve. Ato janë forumi kryesor për bashkëveprim shoqëror, ato i lidhin vendet ku ne duhet të shkojmë për plotësimin e nevojave tona (shkollë, punë, kujdes shëndetësor, dyqane, etj) dhe janë perspektiva nga të cilat ne fitojmë përvojat tona të përditshme. Dizajni urban

përpiket tu mundësojë njerëzve që të përfitojnë më shumë nga rrethi i tyre.

Ndryshimi i këtij raporti jo të shëndoshë kërkon intervenim në mjedisin e krijuar për të harmonizuar atë me kërkesat gjithnjë e më të mëdha dhe për tu mundësuar njerëzve të krijojnë lidhje të reja me njëri tjetrin dhe me rrethin e tyre, ndërkohë që i mënjanon ndikimet negative të përjashtimit shoqëror, brishtësisë ekonomike dhe dëmtimit të tyre fizik.

Dizajni urban përpiket të krijojë vende (hapësira) domethënëse për njerëzit që i shfrytëzojnë ato për tu dhënë njerëzve mundësi që të plotësojnë nevojat e tyre. Megjithatë, përcaktimi i nevojave të njerëzve nuk është gjithmonë i lehtë. Qoftë si individë, qoftë si komunitete, nevojat e njerëzve do të ndryshojnë shumë. Ato mund të ndryshojnë me kalimin e kohës dhe nga një njeri tek tjetri. Se për çka do të ketë nevojë një person në një moment të caktuar varet nga gjinia e tij, moshja, mënyra e rritjes, përvoja, vlera, periudha e ditës (ata mund të jenë të lodhur ose të uritur, etj). Dizajni i hapësirave që janë të rëndësishme për çdokënd nënkupton hapësira që mund të përdoren në mënyra të ndryshme nga shumë njerëz. Hapësira urbane është shumë e çmuar për ta përdorur vetëm për një qëllim të vetëm. Në dizajnin urban, sikurse në natyrë, monokultura është më e mira kur ajo shmanget plotësisht. Një dizajn i mirë nuk kushton shumë më shtrenjtë, e as nuk merr më shumë kohë për tu përfunduar, se sa një dizajn i dobët. Dëshira për të arritur këto qëllime për Kosovën është e vetëkuptueshme, por se sa mund të arrihen ato varet nga dy faktorë kryesorë:

Ndoshta më e rëndësishmja është aftësia për të krijuar një kulturë të dizajnit urban. Ne të gjithë kemi ndikim në cilësinë e rrethinës sonë, nga kryetarët e komunave dhe planifikuesit të cilët marrin vendime të mëdha, deri tek njerëzit që ecin nëpër rrugë, buzëqeshja apo qeshja e të cilëve për një moment e ndriçon hapësirën, ose ndonjë person që hedh bërrilok ose e parkon autom

jetin në shtegun për këmbësorë. Është shumë e rëndësishme që t'i bëjmë njerëzit të çmognë hapësirën e përbashkët, të njohin kontributin e asaj hapësire për jetën e njerëzve dhe të kryejnë mandatin demokratik për qytetet që të bëjnë përmirësime dhe të paguajnë për përmirësimet e bëra. Kjo mund të duket si një kërkesë e madhe por udhëheqja vizionare dhe programet e koordinuara të informimit, edukimit dhe punëve publike, e kanë ndryshuar kulturën e qyteteve (dhe kanë gjetur përfitime ekonomike) në vende të ndryshme si në Bogotë të Kolumbisë, Kopenhagë të Danimarkës, Melburn të Australisë dhe Tiranë të Shqipërisë.

Pika e dytë, që është e lidhur shumë ngushtë me pikën e parë, është zhvillimi i një ndjenje unike kosovare për dizajnin urban. Në fund të fundit, sjellja e dizajnerëve urbanë nga jashtë nuk është e qëndrueshme, pavarësisht se sa janë të mirë ata planifikues. Përtej disa rregullave themelore që kanë të bëjnë me qasjen, komfortin dhe sigurinë, ajo çka është 'e mirë' në masë të madhe është e veçantë për secilën kulturë, dhe njerëzit më të përshtatshëm për ta të kuptuar më së miri një vend janë njerëzit për të cilët ai vend është përvojë e përditshme.

Nëse bëhen këto ndryshime, qytetet dhe fshatrat e Kosovës mund të bëhen vende në të cilat njerëzit rishtas të urbanizuar do të kenë më shumë mundësi që të lulëzojnë dhe të shfaqin gjithë potencialin e tyre. Kjo është pjesë esenciale e arritjes së maksimumit me pasurinë më të madhe të Kosovës: njerëzit e saj, dhe për të ndihmuar ata që të bëhen konkurrues në mënyrë të barabartë me qendrat e tjera evropiane. Unë kam qenë mjaft me fat që më është kërkuar të ndihmojë në këtë sfidë. Shpresoj se do të kthehem në Kosovë në shkurt të vitit 2008 për të punuar me komunat në hulumtimin e proceseve dhe mjediseve që do tu mundësojnë atyre të punojnë drejt këtij qëllimi.

Jenny Donovan,

Eksperte për dizajn urban në MuSPP




DREJT KONTEKSTIT TË DIZAJNIT URBAN

Puna e grupit punues për mobilitet dhe transport në komunën e Mitrovicës ka qene e fokusuar fuqishëm në zhvillimin e një projekti të ri-zgjerimit e propozimit fillestar për demo projektin, në kryqëzimin e hyrjes jugore të qytetit. Lokacioni i trekëndëshit/skajit të parkut Solana, njërës nga pikat kryesore të hyrjes/ daljes në qendër të qytetit është, po ashtu edhe lidhja e qytetit me parkun Solana dhe paraqet një hapësirë e rëndësishme publike në këtë zonë.

Një proces kreativ i rehabilitimit të këtij lokacioni, që konsiderohet se do të jetë pjesë e parkut Solana në të ardhmen, do të kishte një ndikim mjaft të madh në krijimin e një vendi unik-pjesë e një fushe të kuptueshme publike, me synim të rikrijimit të zonave urbane cilësore dhe të një mjedisi më gjithëpërfshirës.

Në këtë aspekt, rekomandimet e bëra nga eksperti i MuSPP/UN-HABITAT në dizajn urban u përqaftua nga grupi. Në planin kryesor të projektit janë duke u zhvilluar nga

planerët idetë për krijimin e një sheshi të zbuluar në qendër të trekëndëshit, që do jetë i rrethuar me zona ku njerëzit mund të ulen në hije, me shumë gjelbërim dhe e lidhur me shtigje të vazhdueshme dhe me lidhje logjike dhe vendkalime të sigurta, duke ofruar qasje të sigurt në stacionin e minibusëve nga sheshi dhe në zonën e parkut në të ardhmen. Vëmendje e veçantë i është dhënë sigurisë së këmbësorëve, përmes shfrytëzimit të elementeve të ndryshme strukturore që parandalojnë keqpërdorimin e zonave për këmbësorë, si dhe përmes lidhjeve të ardhshme me parkun Solana. Planifikimi hapësinor është një ndër gjërat më të përhershme për një vend dhe mund të ketë implikime afatgjate, prandaj rrugët, shtigjet e këmbësorëve dhe hapësirat publike të planifikuara dhe dizajnuara me kujdes, bëhen të domosdoshme, jo vetëm të përcaktojnë mënyrën si lëvizin njerëzit nëpër qytetet e tyre por edhe se si e përjetojnë ata qytetin e tyre.



MOBILITETI DHE DIZAJNI

Në pjesën veriore të Mitrovicës, trafiku, automjetet e parkuara dhe këmbësorët po luftojnë për sasinë e kufizuar të hapësirës publike në qytet. Një grup punues për 'mobilitetin dhe transportin', i përbërë nga profesionistë vendorë dhe ndërkombëtarë nga administrata e UNMIK-ut, Shërbimi Policor i Kosovës, Policia civile e UNMIK-ut dhe ekipi i MuSPP/ UN-HABITAT-it, si dhe nga përfaqësuesit lokal të shoqërisë civile, është duke punuar për përmirësimin e mobilitetit, duke lehtësuar këtë luftë për hapësirë me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës në qytet.

Ky grup punues, i mbështetur nga MuSPP/ UN-HABITAT-i, u zotua të kontraktonte një ekspert të transportit nga Universiteti i Novi Sadit për të ndihmuar në formulimin e projekt propozimeve që do të ishin si pikë fillestare në përmirësimin e mobilitetit dhe transportit në pjesën veriore të Mitrovicës. Këto propozime e parashtronin nevojën për hapjen e stacioni të ri hekurudhor, mundësitë e sigurimit të transportit publik dhe çështje të tjera të dizajnit urban gjatë ndarjes së hapësirës publike nëpër lagje.

Rekomandimet e këtij studimi ishin:

- Lokacioni më i mirë për stacionin e ri hekurudhor është në vazhdimin e rrugës John Kennedy
- Duhej përcaktuar një shteg për çiklistë

deri te dhe prej stacionit hekurudhor

- Një propozim për ndërtimet e nevojshme dhe lidhjen e infrastrukturës rrugore do të ndihmonte në arritjen e një trafiku më të ekuilibruar dhe mund të aplikonte lëvizjet njëdrejtimëshe për të krijuar hapësira të reja për parkim

- Mundësitë dhe kushtet për instalimin e teleferikut, kabllos ose liftit për transportimin e njerëzve deri në kishë, për të eliminuar qarkullimin e automjeteve, përveç rasteve kur kjo bëhet me leje të veçantë.

- Transporti publik duhet të privatizohet plotësisht, por organizimi dhe regjimi i punës duhet të përcaktohen nga autoritetet lokale.

Kjo punë është paraqitur dhe diskutuar në një forum publik dhe do të finalizohet së shpejti, me qëllim që të fillohet me përmirësimet vitin e ardhshëm.



Zgjidhja e problemeve të trafikut dhe atyre urbane në pjesën veriore të Mitrovicës

Me 25 tetor 2007, në Mitrovicë (në pjesën veriore) u prezantua një projekt propozim i madh për zgjidhjen e problemeve të trafikut dhe atyre urbane. Me këtë rast, Dr. Milomir Veselinovic, ekspert i transportit nga Universiteti i Novi Sadit, prezantoi propozimin që synon të përmirësojë cilësinë e jetës në qytet përmes përmirësimit të mundësisë së lëvizjes. Dr. Veselinovic deklaroi se hapi tjetër është konfigurimi i propozimit të paraqitur në dokument dhe informimi i institucioneve përkatëse që punojnë në këtë fushë, si dhe i strukturave politike që janë të rëndësishme për zbatimin e këtij projekti.

"Kontributi më i madh i këtij propozimi dhe ambicia që duhet ta ndjekim është se trafiku duhet të funksionojë aty ku duhet të funksionojë në mënyrë të natyrshme. Për këtë na duhen lidhjet rrugore dhe kjo bëhet në mënyrë praktike, hap pas hapi. Këto janë investime shumë të vogla dhe janë shumë sosh individualisht. Mund të zbatohet një regjim të caktuar të sjelljes së disiplinuar dhe konkrete të njerëzve në rrugët kryesore me semaforë dhe lëvizjen e këmbësorëve, çiklistëve dhe personave me aftësi të kufizuara", tha Dr. Veselinovic. Ai po ashtu shtoi se kjo iniciativë nënkupton angazhimin e të gjitha strukturave në zgjidhjen e problemit të funksionimit të trafikut dhe ai ishte shumë optimist për zbatimin e tij.

Burimi: Kontakt Plus Radio, 25/10/07

NJË KONCEPT I DIZAJNIT PËR DEMO PROJEKTIN E PARKUT QENDROR NË GJAKOVË

Një koncept i dizajni është përgatitur nga eksperti i MuSPP/UN-HABITAT-it në dizajnin urban për përmirësimin e parkut qendror të qytetit të Gjakovës. Qëllimi i këtij koncept dizajni është që të nxisë një diskutim rreth proceseve dhe hartimit të një dizajni të drejtë urban. Komuna e Gjakovës ia ka paraqitur MuSPP/ UN-HABITAT-it këtë projekt si propozim për demo projekt. Ky propozim i konceptit të planit është pjesë e serisë së aktiviteteve të MuSPP-së për të demonstruar një proces të planifikimit me pjesëmarrje të gjerë.

Propozimit fillestar i mungonte pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e planifikimit dhe përpilimit, e cila është një kriter i rëndësishëm për një demo projekt të suksesshëm. Për këtë arsye ekipi i MuSPP-së në Ditën Botërore të Habitat-it 2007 e organizoi në Gjakovë një manifestim të quajtur "një shëtitje nëpër parkun e qytetit", në bashkëpunim me përfaqësuesit e autoriteteve lokale dhe të Këshillit Joformal të organizatave të shoqërisë civile. Në këtë manifestim morën pjesë edhe një numër i përfaqësuesve të qytetarëve si nxënës, të rinj, gra dhe të moshuar, të cilët dhanë komentet e tyre mbi atë se si kjo zonë e gjelbër mund të kontribuojë në cilësinë e jetës në qytet. Koncept dizajni i ekspertit të MuSPP-së i interpreton konkludimet nga ky manifestim dhe e paraqet procesin me të cilin është hartuar plani. Të dy këto elemente (procesi dhe plani) janë të rëndësishme, por dobia e këtij plani qëndron në dokumentimin e mënyrës së si këto të dyja lidhen njëra me tjetrën, duke ofruar një shembull se si mund të zhvillohet një proces gjithëpërfshirës dhe i drejtë i dizajnit urban. Procesi ka katër komponentë:

- Kuptimin e lokacionit si përbërje fizike dhe si përbërje shoqërore
- Përgatitjen e agjendës së hartimit, duke paraqitur sugjerimet të cilat duhet të jenë prioritetet
- Një zgjidhje të mundshme të dozajnit, e cila i adreson ato prioritetet
- Arsyetimin e dizajnit, i cili paraqet më në hollësi se si mund të arrihen ato objektiva me këtë koncept.

Normalisht, hartimi i dizajnit bëhet bashkë me testimin e tij me komunitet



tin, por kufizimet kohore nuk e kanë mundësuar një gjë të tillë. Si rezultat, koncepti i dizajnit është paraqitur si një shembull i asaj që mund të arrihet dhe si ide për tu shqyrtuar nga palët me interes, e jo si propozime që ofrojnë zgjidhje të plotë. Hapi tjetër në këtë proces është konfirmimi, ndryshimi ose braktisja e koncepteve dhe supozimeve që janë hulumtuar në këtë koncept të dizajnit. Sugjerimet kryesore përfshijnë:

- Një kafene dhe një bllok i ri i objekteve sanitare, të inkorporuar në një

strukturë të portretizuar e cila mund të ndihmojë në ofrimin dhe përmirësimin jo vetëm të parkut por edhe të tërë qytetit, duke e njohur rëndësinë e këtij lokacioni (shih ilustrimin).

- Përmirësimet e peizazhit për të ruajtur dhe përmirësuar karakterin e parkut
- Ulëse të reja, ndriçim dhe përmirësim të lodrave
- Shtigje të reja për t'iu përgjigjur "dëshirave" ekzistuese dhe për të përmirësuar qasjen brenda parkut dhe në qendrën e afërt të qyteti.

Demo-projekti në Ferizaj

KONKURSI NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIN IDEOR Projekti i Qendrës së Mobilitetit

Si rezultat i disa aktiviteteve të grupit punues për lëvizjen që trajtonin çështjet e lëvizjes dhe qarkullimit duke shfrytëzuar mësimet e mësuara nga vizitat studimore në Lund të Suedisë, Komuna e Ferizajt vendosi të punojë në konceptin e qendrës së mobilitetit, e cila integron stacionin e trenit dhe stacionin e autobusëve.

Me një përparim të mëtejshëm dhe me pranimin e tij nga Kuvendi Komunal, ky koncept u zgjodh si demo-projekt për një konkurs ndërkombëtar për hartimin e planit të bazuar në idenë e projektit për qendrën e mobilitetit. Ky demo-projekt është bashkëfinancuar nga komuna e Ferizajt dhe MuSPP/UN-HABITAT-it.

Është krijuar një Komision përzgjedhës, i përbërë nga përfaqësuesit përkatës të Hekurudhave të Kosovës, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit (MTPT), komu-

nitetit të biznesit, nga përfaqësuesit e shoqatës së transportuesve privatë dhe shoqërisë civile, MuSPP/UN-HABITAT-it dhe të komunës. Ky grup do të vendos për rezultatin përfundimtar të këtij konkursi duke marrë parasysh këshillat e një paneli teknik.

Ky projekt është një e arritur pasi që integron nivele të ndryshme të planifikimit dhe vendimmarrjes, sektorët e ndryshëm, shoqërinë civile dhe inkurajon partneritetin publik-privat në hartimin e projekt propozimeve. Të gjitha zotimet për këtë proces, parimet dhe faktorët specifik në kontekstin e zhvillimit të ardhshëm të qytetit janë përfshirë në "Kartën urbane të qytetit të Ferizajt", e cila në të njëjtën kohë është edhe pjesë e dokumentacionit teknik për këtë konkurs.

Koncepti i qendrës së mobilitetit, përmes integritit të stacionit hekurudhor dhe atij të autobusëve, përpiqet të promovojë

një sistem transporti me shumë modele dhe të përmirësoshë në mënyrë të qëndrueshme transportin ekzistues në Ferizaj. Ai do të ndihmojë edhe për të arritur një lidhje funksionale të qytetit me qëllim të rigjenerimit të qendrës së qytetit si dhe të krijimit të një identiteti të ri që Ferizaj do ta fitojë për shkak të hekurudhës.

Shpallja e konkursit ndërkombëtar për projekt-idenë mbi qendrën e mobilitetit në Ferizaj synon që të mbledh idetë më të mira për zbatimin e këtij koncepti. Konkursi është shpallur me 17 nëntor 2007 në më shumë se 17 faqe ndërkombëtare të internetit dhe afati i fundit për të paraqitur propozimet është 17 marsi 2008.

Për më shumë informata vizioni faqen tonë të internetit: www.unhabitat-kosovo.org dhe www.ferizaj-komuna.org.



Use of Building

Detached House	Public facilities
Flat with shop	Public transport
Flat with services	Under Constructio
Commercial	Unused or Destroy building
Industry	Others
School	

Planifikimi urban

PRAKTIKAT E MIRA PËR “KRIJIMIN E QYTETEVE TË HARMONIZUARA”

“Krijimi i qyteteve të harmonizuara” ishte motoja e takimi të grupit të ekspertëve (TGE) të mbajtur në Romë me 29 dhe 30 nëntor 2007. Peja ishte njëra nga qytetet e përzgjedhura pas një procedure zyrtare të aplikimit dhe aprovimit të zhvilluar nga organizatorët e konferencës. Në atë takim u përfaqësuan dymbëdhjetë qytete. Si rezultat i këtij takimi doli një draft me rekomandimet të cilat në fund duhet të aprovohen gjatë Forumit Botëror Urban IV në Nanjing të Kinës. Agron Sallova (Këshilltar për planifikim urban i UN-HABITAT/MuSPP) dhe Modest Gashi (Planifikues urban nga Komuna e Pejës) morën pjesë në TGE në Romë.

Qëllimi i konferencës ishte shkëmbimi i metodologjive dhe përvojave të planifikimit urbanistik si mjete me të cilat mund të bëhet një urbanizim i qëndrueshëm, me fjalë të tjera, mund të bëhen “qytete të harmonizuara”. Këto qytete të harmonizuara

në të njëjtën kohë do të sjellin zhvillim ekonomik, do të trajtojnë varfërinë urbane dhe do të zvogëlojnë ndotjen ekologjike të qytetit. Qëllimi i saj ka qenë që të bëhen përpjekje për të gjetur mënyrën më të mirë për të vepruar në arritjen e kësaj. Prezantimi i secilit qytet pritej të kontribuonte në lidhje me:

- Inovacionet e identifikuara në praktikën e planifikimit urban
 - Analizën dhe krahasimin e problemeve kryesore në hartimin dhe zbatimin e planeve të qëndrueshme urbanistike.
 - Identifikimin e zgjidhjeve alternative të planifikimit në qytetet pjesëmarrëse.
 - Mundësitë e bashkëpunimit të ardhshëm.
 - Përzgjedhja e shembujve më premtues të planifikimit për qytete të harmonizuara.
- Prezantimi i qytetit të Pejës la një përshtypje të mirë tek të gjithë pjesëmarrësit dhe si rrjedhim u zhvilluan shumë disku time bilaterale. Një informacion që ishte



veçanërisht i rëndësishëm për TGE-në ishte informacioni për aspektet inovative të procesit të planifikimit, mjetet e aplikuar dhe kornizat e qarta për zbatimin e planit. Për kontekstin e Kosovës është e rëndësishme edhe mundësia e angazhimit më të madh të qytetit të Pejës dhe MuSPP/UN-HABITAT-it në FBU në Nanjing të Kinës që do të mbahet në vitin 2008. Pritet që shumë shpejtë në faqen e internetit të UN-HABITAT-it do të publikohen të dhëna të rëndësishme.

KOMUNA E GJILANIT ËSHTË AFËR BËRJES ME PLAN ZHVILLIMOR KOMUNAL

Më 26 nëntor 2007 komuna e Gjilanit filloi shqyrtimin publik të Planit zhvillimor komunal (PZHK) në përgatitjen e të cilit ishin përfshirë pothuaj të gjitha palët me interes: ekipi i planifikimit nga drejtorja e Urbanizimit, Rindërtimit dhe Mjedisit dhe nga drejtoritë e tjera, përfaqësuesit e shoqërisë civile, mediat, qytetarët dhe komuniteti i biznesit. Procesi i hartimit të këtij plani u mbështet nga MuSPP/UN-HABITAT-i dhe në faza të caktuara edhe nga projekti i USAID-it- Iniciativa për Qeverisje Lokale (LGI).

Vetë hapja solemne e shqyrtimit publik të planit, i cili do të zgjat deri më 25 janar 2008, tuboi një numër të interesuarish në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Gjilanit. Disa qytetarë e shfrytëzuan kohën e shkurtër që kishin në dispozicion në këtë takim për të bërë pyetje, sugjerime dhe propozime.

Sidoqoftë pritet që në ditët në vijim qytetarët do të shikojnë më me kujdes planin e propozuar dhe të shfrytëzojnë mundësinë që të kuptojnë më shumë për atë që është propozuar për t'u njohtuar me zhvillimet që parasheh plani dhe për të dhënë propozimet dhe komentet e tyre. Me planin e ofruar, Gjilani shihet si pikëtakim i dy trekëndëshave: Prishtinë-Ferizaj-Gjilan dhe rajonit ndërkufitar në mes të Gjilanit-

Bujanocit (Serbi)-Kumanovës (Maqedoni). Deklarata e vizionit që del nga ky plan është:

Duke shfrytëzuar pozitën qendrore në trekëndëshin e dyfishtë, Gjilani do të jetë një urë moderne ndërlidhëse, që ofron shërbime cilësore në një mjedis të qëndrueshëm, edukim dinamik me teknologji moderne që mbështet zhvillimin ekonomik, me theks të veçantë në zhvillimin e bujqësisë e në funksion të Përmirësimit të kushteve të jetesës në zonat urbane dhe rurale dhe në partneritet të plotë; identitetin do ta fuqizojë në vlerat kulturore e qytetare si një qendër rajonale universitare.

Ne, si palë e interesuar dhe e angazhuar në procesin e planifikimit, shpresojmë që Kuvendi i Komunal i dalë nga zgjedhjet, do të pranojë propozimin përfundimtar të planit pas shqyrtimit publik dhe se do të gjej mënyra për bashkëpunimin dhe për partneritetin privat dhe publik në zbatimin e këtij plani.

Naim SHAQIRI, Koordinator

Në emër të OJQ-së “Peace with Nature”



UDHËZIMET E KËSHILLTARIT PËR KONTRAKTIMIN E JASHTËM PËR HARTIMIN E PZHK-SË

Komuna e Prizrenit ka vendosur ta kontrakttojë një organizatë të jashtme për të hartuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK). Si rezultat i këtij vendimi, MuSPP/UN-HABITAT-i në Prizren dhe ekipi komunal i planifikimit (EKP) e krijuan një grup më të vogël nga grupi i gjerë i EKP-së për hartimin udhëzimeve gjithëpërfshirëse të konsulentit për hartimin e PZHK-së. Pas procesit të konsultimeve të këtij grupi të ngushtë thelbë-

sor u hartuan udhëzimet këshillëdhënëse. Ky grup i ngushtë pastaj ka zhvilluar disa takime me departamentin e prokurimit në mënyrë që të negociohet dhe përfundohet procesi i tenderit. Si rezultat i konsensusit të arritur, Komuna e Prizrenit e shpalli tenderin për hartimin e PZHK-së në gazetën ditore. Udhëzimet këshillëdhënëse e theksojnë në mënyrë të qartë se nga kontraktuesi fitues pritet që të

zhvillojë strategjinë dhe politikën për zhvillimin e komunës së Prizrenit, duke inkorporuar të gjitha elementet e qëndrueshmërisë, d.m.th., zgjidhje inovative për transportin, metodat e zhvillimit, praktikën e ndërtimit dhe menaxhimin afatgjatë urban dhe rural, etj. Strategjia dhe politikën e zhvilluara duhet t'ia rrisin vlerën cilësisë së jetës për banorët e tanishëm dhe të ri, për bizneset dhe vizitorët në Komunë.

Progresi i demo projektit

KRIJIMI I NJË AMBIENTI MË TË SIGURT SHKOLLOR

Komuna e Prizrenit e ka shpallur tenderin për këtë demo projekt në gazetën ditore më 14 nëntor 2007. Hapja e ofertave për demo projektin është bërë në Komunën e Prizrenit më 10 dhjetor 2007 në praninë e ofertuesve dhe të MuSPP/UNHABITAT-it.

Demo projekti ka për qëllim që të krijojë një ambient më të sigurt shkollor

përmes rindërtimit të mureve të shkollës "Lidhja e Prizrenit" në Prizren, i cili për momentin është i pasigurt si për nxënësit ashtu edhe për këmbësorët e tjerë.

Për ta qarë projektin përpara, ekipi i MuSPP-së në Prizren ka zhvilluar disa takime me OJQ-në rinore lokale "Fisnikët" dhe ka filluar të shqyrtojë përfitimën e

madh që ka nga ky projekt komuniteti që jeton afër shkollës dhe i tërë qyteti.

Përfaqësuesit e kësaj OJQ-je e shprehën gatishmërinë që të angazhohen në gjetjen e ideve nga të cilat do të përfitonin të gjitha palët e përfshira.

KËNDI I UN-HABITAT-IT

DITA BOTËRORE E PLANIFIKIMIT TË QYTETIT

08/11/2007, Edinburg, Skoci

Mënyra se si janë duke u rritur dhe zhvilluar sot qytetet është e paqëndrueshme; shoqata e planerëve e Komonveltit, në një deklaratë të saj, u bënë thirrje qeverive që të "mendojnë mirë" para se të jetë tepër vonë. "Kemi dhjetë, ndoshta 20 vjet që të fusim gjërat në binarë. Pas kësaj, problemet e lagjeve të varfra, dëmeve në mjedis dhe pasiguria urbane do të bëhen aq të rënda sa që do të dominojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare edhe të pjesës tjetër të vendit", theksoi kryetari i shoqatës, zj. Christine Platt, planerë, e cila punon në Afrikën e Jugut.

Në deklaratën me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Planifikimit të Qytetit, ajo tha se rreth 327 milionë njerëz në vendet e Komonveltit jetojnë në lagje të varfra, shifra këto që rriten nga dita në ditë. Jetëgjatësia e tyre e pritshme është shumë me e shkurtër se sa e bashkëqytetarëve të tyre që jetojnë në kushte më të mira.

"Pasi që të varfrit jetojnë në zonat më të rrezikshme ata janë shumë më të rrezikuar nga ndikimi i ndryshimeve klimatike"

theksoi zj Platt duke shprehur pikëpamje të ngjashme me atë të shprehur kohëve të fundit nga drejtoresha ekzekutive e UN-HABITAT-it, znj, Anna Tibaijuka. "Problemet janë veçanërisht të mëdha në shtetet e vogla në zhvillim që gjenden në ishuj, ku ekziston një rrezik gjithnjë e më i madh nga rritja e nivelit të detit dhe nga kushtet klimatike ekstreme, të cilat nuk përcillen paralelisht me zhvillimin e kapaciteteve të planifikimit dhe menaxhimit në mënyrë të qëndrueshme dhe të drejt. Zhvillimi urban në këtë gjeneratë do të jetë i madh. Ai do të krijojë pasuri të madhe, e cila do t'i nxjerr njerëzit nga varfëria. Megjithatë, ne duhet t'i bëjnë qytetet si duhet, dhe kjo kërkon planifikim të mençur", tha znj. Platt, e cila kohëve të fundit ka vizituar Indinë për të parë se si po merren atje me pasojat urbane të një zhvillimi të shpejtë ekonomik. Ne duhet të bëjmë një hap të madh në kapacitetin menaxhues: të kemi më shumë njerëz më të aftë dhe një legjislacion më të përshtatshëm të planifikimit, i cili u përgjigjet kërkesave të sotme në botë. Kjo është diçka në të cilën ne jemi duke punuar, bashkë me institutet tona anëtare,

me partnerët tonë nga Komonvelti dhe me UN-HABITAT-in. Shumë shpesh, edhe në vendet e pasura, qasja e qeverive ndaj zhvillimit urban është sikurse dhënia e medikamenteve shëruese: sanimi dhe zhvillimi i infrastrukturës pasi të ketë ndodhur zhvillimi, bëhet shumë pak dhe bëhet shumë vonë për mbrojtjen e mjedisit. Planifikimi do të thotë ilaç parandalues; ai nënkupton se duhet të vepohet tani që të mos lejohet degradimi i qyteteve tona dhe zonave rurale deri në atë masë që do ta bënte shumë më të kushtueshme riparimin e gjendjes. Ka disa sinjale inkurajuese që tregojnë se disa qeveri të Komonveltit janë duke e kuptuar se duhet t'i kthehen planifikimit.

Shoqatën e planerëve të Komonveltit e përbëjnë institutet profesionale të planifikimit nga më shumë se 25 vende të Komonveltit. Për disa vite, Forumi i qeverive lokale të Komonveltit, me rreth 200 anëtarë në më shumë se 40 vende të Komonveltit ka bashkëpunuar ngushtë me UN-HABITAT-in në shumë vende anekënd botës.

PROGRAMI MuSPP MERR DONACION PËR FAZËN E DYTË

Sida, UN-HABITAT-i dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) janë takuar sërish me 6-8 nëntor 2007, për të diskutuar progresin e Programit të MuSP-së dhe për të bërë plane për të ardhmen. Data fillestare e përmbylljes së programit u shty deri në prill 2008, gjë që mundësoi përfundimin e aktiviteteve të tanishme dhe zhvillimin e propozimit përfundimtar për fazën e dytë të Programit.

Diskutimet u përqendruan në avancimin e planeve zhvillimore komunale dhe urbane, në demonstrimin e projekteve, në bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe në çështjet e tjera kyçe të cilat duhet të trajtohen në fazën e dytë të programit.

Shqyrtimi i të arriturave të periudhës gjashtëmujore prej prillit deri në shtator 2007 përfshinte:

- Miratimin e **PZHK/PZHU-së** për Pejën nga Asambleja Komunale dhe puna e më pastajme për zhvillimin e kornizës për zbatim. Procesi i zhvillimit të planit komunal dhe urban u përzgjedh si rast studimor për Takimin e ekspertëve të planifikimit urban në Romë, të organizuar nga zyra e praktikave më të mira pranë UN-HABITAT-it. Komunitet e tjera janë në fazën përfundimtare të hartimit të këtyre planeve dhe tashmë janë duke u zhvilluar proceset e shqyrtimit publik në Gjakovë dhe në Gjilan gjatë takimit të TPR-së.

- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe **tri punëtori të vizionimit**, të cilat mundësuan përfundimin e procesit në të gjitha komunat partnere. Planerët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile që janë aktiv në Këshillat joformal të organizatave të shoqërisë civile nga Gjakova, Peja dhe Prizreni, punuan së bashku gjatë këtyre pesë ditëve të punës intensive në zhvillimin e një vizioni të përbashkët për qytetet e tyre. Në një numër komunash, autoriteteve lokale, pas përfundimit të këtyre punëtorive, u dorëzohet vizioni për tu përfshirë në dokumentet e tyre të planifikimit. Këto ngjarje u mbuluan gjerësisht nga mediat lokale, përfaqësuesit e të cilave kishin qenë të përfshirë në procesin e krijimit të vizionit.

- Në mënyrë të suksesshme u filluan **shtatë projekte të demonstrimit**, të cilat paraqesin një hap të rëndësishëm në procesin e planifikimit. Projekt propozimet e parashtruara për bashkëfinancim nga MuSPP kanë të bëjnë me



hapësirat publike, shtimin e sigurisë së ambienteve shkollore dhe mobilitetit më efikas në zonat urbane. Dita Botërore e Habitatit, që tradicionalisht shënohet me 1 tetor, ofroi edhe një mundësi më shumë për promovimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe për angazhimin e qytetarëve në diskutimet rreth zbatimit të projekteve si pjesë e procesit të zhvillimit urban.

- Për shkak të fushatave të vetëdijesimit dhe punëtorive mbi **vendbanimet joformale**, komunat partnere filluan të identifikojnë këto vendbanime dhe filluan veprimet për planifikimin e tyre. Bashkëpunimi me MMPH-në dhe me grupet e përbashkëta të punës për vendbanimet joformale vazhdoi gjatë tërë kësaj periudhe dhe gjatë takimit të TPR-së u avancuan mjaft mirë përgatitjet për një konferencë/ punëtori mbarë-kosovare. Pak para takimit të TPR-së u bë një analizë e hollësishme e legjislacionit ekzistues si dhe e kontekstit shoqëror dhe planifikues për përgatitjen e terrenit për zhvillimin e një strategjie mbarë-kosovare mbi IFS-të, e cila duhet të përgatitet nga MMPH-ja.
- Programi punoi në mënyrë intensive me Ministrinë dhe me disa komuna, veçanërisht Prizrenin, në çështjet e zonave të veçanta mbrojtëse, siç definohej në propozimin e Ahtisarit. Programi po ashtu filloi të aplikojë konceptin e Indeksit të Qeverisjes Urbane, si mjet për të analizuar aspektet e ndryshme të qeverisjes. Komuna e Gjakovës themeloi një grup të përbërë nga shumë palë me interes për këtë qëllim dhe filloi të punojë në raportin e saj.

Një pjesë e takimit të TPR-së ishte e përqendruar në diskutimin më të hollësishëm të propozimit për vazhdimin e fazës së dytë të MuSPP-së. Konsultimet e bëra me MMPH-në, me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe me përfaqësuesit e qeverive lokale konfirmuan nevojën për mbështetje të mëtejshme profesionale si për komunat po ashtu edhe për nivelin qendror, në konsolidimin e praktikës së planifikimit. Me një presion të vazhdueshëm për investime kapitale për t'iu përgjigjur prioritetëve kyçe lokale, është shumë e rëndë

sishme të sigurohet se rezultatet e tyre nga proceset e planifikimit të zhvillimit komunal dhe urban dhe ndikimi i tyre në mjedis të jenë në përputhje me agjendën zhvillimore të komunës. Praktishtë, kjo nënkupton optimizimin e shfrytëzimit të tokës dhe politikave për menaxhimin e tokës, mbrojtjen e mjedisit natyror, përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e objekteve të banimit në zonat që janë më të përshtatshme për investime të tilla. Është theksuar edhe nevoja për një bashkëpunim më të madh ndërkomunal në lidhje me **zonat rajonale të bashkëpunimit** të identifikuar në Planin Hapësinor të Kosovës. Kjo do të mundësoi përfshirjen e disa komunave më të vogla në Program. Një fushat tjetër e interesit për MuSPP 2 duhet të jenë vendbanimet joformale dhe mënyrat se si trajtohet kjo çështje në nivel qendror, lokal dhe në nivel të komunitetit. Fokusi në grupet më të rrezikuara dhe përgjigja ndaj kërkesave të meshkujve dhe femrave, si në aspektin e pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse ashtu edhe në përfitimet e pritshme nga iniciativat e planifikimit dhe nga projektet kapitale do të jetë një element shumë i rëndësishëm në fazën tjetër të MuSPP. Takimi i TPR-së po ashtu i ofroi mundësi stafit të MuSPP-së që të degjojnë më shumë nga përfaqësuesit e Sida-s nga Zyra e Stokholmit dhe nga Kosova, rreth përshlyetjeve të tyre nga rishikimi i aktiviteteve të MuSPP1 dhe për planet për të ardhmen, si dhe të mësojnë rreth iniciativave më të fundit të Zyrës Qendrore të UN-HABITAT-it në Najrobi, siç janë fushata për urbanizimin e qëndrueshëm në zhvillimin e tanishëm, përgatitjet për **Forum Botëror Urban** që do të mbahet në Nanjing, më 13-17 tetor 2008, nën moton e urbanizimit të harmonizuar, ku rasti i Pejës pritet të paraqitet në njërin nga seancat e këtij forumi.

Pjesëmarrësit në TPR vizituan vendbanimin joformal Kolonia në Gjakovë dhe u takuan me përfaqësuesit e pilot njësive komunale dhe me përfaqësuesit e organizatës Trashëgimia kulturore pa kufij (CHWB) për të diskutuar rezultatet e punëtorisë për paraqitjen e vizionit në Junik.

VENDBANIMET JOFORMALE – ATY JETOJNË KOMUNITETET

Vendbanimet joformale janë pjesë e realiteti urban jo vetëm në Ballkan por në shumë vende në mbarë botën, ku deri në 70 për qind e banorëve të qyteteve në këtë botë që zhvillohet me shpejtësi jetojnë pa pasur sigurinë e zotërimit të pronës, pa qasje në shërbime ose pa pjesëmarrje të plotë në strukturat demokratike të qeverisjes. Si të tilla, ato shpesh bëhen zona ku mbretëron varfëria, përjashtimi dhe diskriminimi shoqëror.

Kërkimi i mënyrave efikase për zgjidhjen e çështjes së vendbanimeve joformale (VJ) në Kosovë ka qenë shqetësim i vazhdueshëm i institucioneve të qeverisë qendrore dhe lokale në Kosovë, i donatorëve, OJQ-ve dhe i bashkësisë ndërkombëtare. MuSPP-ja, në bashkëpunim me MMPH-në dhe OSBE-në, ka organizuar një punëtori mbi VJ-të më 11-12 dhjetor 2007. Në këtë punëtori morën pjesë rreth 170 profesionistë nga nivelet qendrore dhe profesionale, ekspertë dhe përfaqësues të OJQ-ve, i cili shërbeu si një forum për shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare, rajonale dhe lokale. Një ndër përfundimet nga takimet e mëherëshme ishte nevoja për të diferencuar dhe ndarë çështjen e VJ-ve që banojnë nga grupet e rrezikuara dhe çështjes së ndërtimeve të paligjshme, të cilat shpesh janë me standarde relativisht të mira por që janë pa leje. Prandaj, agjenda e kësaj punëtorie siguronte trajtimin e të dy këtyre çështjeve. Seancat e punëtorisë trajtuan implikimet ligjore të VJ-ve, përvojat nga përpjekjet për rregullimin e VJ-ve në Pejë, shqyrtimin e gjendjes së komuniteteve romë në Kosovë, gjendjen e tanishme në lidhje me VJ-të në mbarë botën dhe përpjekjet e ndërmarra në Brçko të Bosnjë dhe Hercegovinës për zgjidhjen e çështjes së ndërtimeve pa leje. (Materialet mbi VJ-të mund të gjenden në faqen e internetit <http://www.ks.gov.net/mmph>).

Në vërejtjet hyrëse, shefat e organizatave partnere theksuan se rëndësia që ka qasja gjithëpërfshirëse ndaj VJ-ve, të cilat mund të zgjidhen vetëm përmes përpjekjeve të bashkërenduara dhe të përkushtuara të autoriteteve të niveleve qendrore dhe lokale, të profesionistëve dhe të vet komuniteteve, me mbështetjen e donatorëve dhe organizatave qeveritare. Një nga mënyrat e parandalimit të VJ-ve është përmes krijimit të kushteve për urbanizim të qëndrueshëm. UN-HABITAT-i ka mandatin që të promovojë fshatra dhe qytete të qëndrueshme



në aspektin shoqëror dhe të mjedisit me qëllim që të sigurojë strehim adekuat për të gjithë. Njerëzit në VJ kanë të drejta por kanë edhe përgjegjësi. Ata kanë të drejtë në shërbime, infrastrukturë dhe të drejtë për të kontribuar në praktikën e planifikimit hapësinor. Por ata kanë edhe përgjegjësi për të paguar taksat, faturat dhe të respektojnë rregulloret e planifikimit.

Komunitet për momentin janë në proces të hartimit të planeve të tyre zhvillimore komunale dhe urbane dhe ky proces paraqet një mundësi unike për përfshirjen e VJ-ve në këto plane dhe për sigurimin e varianteve të zhvillimit të tyre të ardhshëm. Vlerësimi i tanishëm flet për rreth 70 vendbanime të tilla në mbarë Kosovën, por komunitet nuk janë gjithmonë të gatshme dhe të përgatitura si duhet teknikisht për të zhvilluar plane për përmirësimin e gjendjes në këto fusha.

Ministria e ka filluar punën rreth strategjisë kosovare për VJ-të, e specifikuar si pjesë e PVPE-së (Planit të Veprimit për Partneritet Evropian), i cili ka për qëllim që të drejtojë iniciativat e reja të qeverisë në këtë fushë. Një nga çështjet e rëndësishme në krijimin e një kornize ligjore të kuptueshme për trajtimin e sigurisë së zotërimit të pronës, menaxhimit të tokës, banimit shoqëror si dhe të politikave të planifikuara mirë për integrimin e banorëve të VJ-ve, veçanërisht grupet e rrezikuara, në veprimet e zhvillimit social dhe ekonomik në Kosovë. Ndonëse është folur shumë për VJ-të e pakicave etnike, veçanërisht ato të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian, duhet të mbahet në mend se në grupet e rrezikuara hyjnë edhe të moshuarit, familjet me kryefamiljare si dhe personat e paaftë dhe të varfër, pa varësisht prejardhjes së tyre etnike.

Mënyrat e zgjidhjes së çështjeve që kanë të bëjnë me VJ-të kanë qenë temë e takimeve për shqyrtimin Deklaratës së Vjenës, të organizuar bashkërisht nga Pakti i Stabilitetit

për Evropën Juglindore dhe UN-HABITAT-i dhe që në dy vitet e fundit është mbajtur në shtetet nënshkruese të Deklaratës. Takimi i 5-të rajonal u mbajt në Podgoricë të Malit të Zi më 21 dhe 22 tetor 2007. Takimet që janë pjesë e programit rajonal për forcimin e kapaciteteve shërbejnë si forum për të mësuar dhe për të shkëmbyer përvoja me vendet pjesëmarrëse. Shumë prej tyre janë në proces të përgatitjes së legjislativës dhe politikave për të trajtuar VJ-të dhe çështjet që kanë të bëjnë me to, siç është legalizimi i objekteve ilegale dhe objekteve të banimit social.

Mësimi nga të tjerët është dëshmuar se është mënyra më e mirë për zhvillimin e koncepteve dhe ideve të përgjithshme, por të cilat duhet të përshtaten në kushtet e veçanta të secilit vend: p.sh., Shqipëria ka vendosur që të bëjë amnisti të përgjithshme të ndërtimeve të paligjshme dhe vetëm më pastaj do të shikoj çështjet e planifikimit urban, për Kroacinë problemi kryesor është mbrojtja e zonave bregdetare nga ndërtimet e paligjshme, për Serbinë fokusi është në objektet e banimit social, Maqedonia është duke punuar në procesin e legalizimit dhe janë duke shqyrtuar çështjet e procedurave dhe kostos së legalizimeve që kanë të bëjnë me gupet e rrezikuara, Kosova ka filluar procesin e zhvillimit të strategjisë mbi VJ-të dhe ka projektligje për trajtimin e objekteve ilegale dhe të banimit social. Nuk ekziston një mënyrë që është e mirë për të gjithë për zgjidhjen e këtij problemi por vendet e rajonit janë të përkushtuara që të punojnë për të arritur progres në këtë aspekt dhe vazhdojnë të kenë vitin 2015 si afat të fundit për zgjidhjen e çështjes së vendbanimeve joformale. Progresi i arritur në këto iniciativa do të paraqitet në takimin e ardhshëm. Në fund të vitit 2007, Pakti i Stabilitetit e përfundoi misionin e tij dhe përgjegjësia për vazhdimin e programit iu dha UN-HABITAT-it.

Konferenca e parë mbi transportin dhe planifikimin hapësinor në Kosovë

ORGANIZIMI, POLITIKA DHE PLANIFIKIMI I TRANSPORTIT PUBLIK

Transporti dhe planifikimi hapësinor janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, si dy anët e të njëjtës monedhë. Ndonëse ekspertët e transportit dhe të planifikimit kanë prioritete, koncepte dhe mjete të ndryshme, ata e ndajnë bashkë përgjegjësinë për ndërtimin e sistemit, ku ka qasje në funksione, ku transporti është efikas dhe ku mallrat dhe njerëzit lëvizin për të siguruar një jetë më të gjallë dhe më të qëndrueshme shoqërore dhe ekonomike.

Në këtë perspektivë, Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit (MTPT), Ministria e mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) dhe MuSPP/UN-HABITAT-i në Kosovë, të mbështetur nga Ndërtimi i Kapaciteteve për Integrim Evropian (UNDP/EU) janë duke organizuar një cikël konferencash mbi transportin dhe planifikimin hapësinor.

Qëllimi i përgjithshëm i këtyre konferencave është që ndihmojnë **dialogun ndërmjet partnerëve nga institucionet e ndryshme**, nga disiplinat profesionale dhe nga sektorët dhe nivelet e ndryshëm organizativ. Konferenca e parë e këtij cikli, e mbajtur më 31 tetor në Hotelin Grand në Prishtinë, i dedikohej transportit publik dhe në të morën pjesë më shumë se 160 persona nga të gjitha grupet e synuara.

Të gjithë ata që morën fjalën theksuan se transporti publik është një ndër çështjet strategjike që përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm të Kosovës: territorit të saj, shoqërisë dhe ekonomisë. **Planifikimi hapësinor, sipas përkufizimit, është edhe planifikimi i transportit.** Vetëm një politikë e kuptueshme, e integruar hapësinore dhe e transportit mund të qoj kah suksesi. Por planifikimi hapësinor me ose për transportin publik është i pakuptimtë nëse nuk do të ketë operatorë të cilët do të ofrojnë atë shërbim. Madje, planifikimi me transportin publik bëhet më efikas nëse operatorët zhvillojnë biznesin e tyre në mënyrë të rregullt dhe të organizuar. Rregullimi dhe organizimi i shërbimit të autobusëve ndërurban në Kosovë mund të cilësohet si një ngjarje e suksesshme, siç u përshkrua nga Qamil Feka, Shef i departamentit të transportit rrugor në MTPT. Sistemi i bazuar në 10 korridore kryesore në të cilin funksionojnë më shumë se 1000 automjete i lidh të gjitha qytetet kryesore dhe dytësore të Kosovës me Prishtinën dhe me njëri tjetrin, çdo ditë prej orës 07:00 deri në 19:00, ku ka deri në 8 nisje/ orë. Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, sistemi financo het krejtësisht nga pagesat e udhëtarëve.



Nga kjo e arritur, sistemi do të evoluojë për të ruajtur hapin me kërkesën për mobilitet dhe me konkurrencën nga automjetet private. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit do të kërkojë:

- Zhvillimi i transportit publik komunal dhe bashkërendimi i tyre me sistemin ndërkomunal, për të formuar një shërbim tërheqës nga "stacioni në stacion" (lidhja logjike ndërmjet rrjeteve përbëhet nga shkëmbimet fizike, oraret e bashkërenduara, informacione të plota dhe të njëtrajtshme dhe, në fund, biletat dhe çmimet e njëjta).

- Transportimi i udhëtarëve me tren mund të luajë një rol gjithnjë e më të madh në këtë sistem të integruar dhe të kontribuojë në mbajtjen dhe zgjerimin e kërkesës për shërbime plotësuese të autobusëve. Shërbimet 'joformale' të minibusëve mund të integrohen në një sistem të rregulluar dhe të organizuar, për të siguruar që ofrimi i shërbimeve të mbetet i pranueshëm në kohë dhe vende margjinale.

- Garantimin i kushteve të mira për funksionimin e autobusëve të të gjitha rrjeteve në rrugët rajonale dhe komunale. Në të vërtetë, me shtimin e numrit të automobilitave në trafik, autobusët po ballafaqohen me më shumë rreziqe dhe vonesa në trafik. Si pasojë e kësaj, shtohen shpenzimet operative ndërsa oferta e këtij shërbimi bëhet më pak tërheqëse. Kjo do të shpie në një rreth të mbyllur, i cili do ta bëjë transportin publik të varet nga subvencionet publike dhe do të bëjë që udhëtarët të mos udhëtojnë me autobusë por me automobila privat, duke shkakuar kështu tollovi më të madhe në trafik, etj. Ky nivel i lartë i organizimit kërkon forma të reja të bashkërendimit ndërmjet autoriteteve publike dhe që janë përgjegjëse për komponentë të ndryshëm të këtij sistemi. Constantin Dellis, menaxher rajonal i Asociacionit Ndërkombëtar të Transportit Publik (ANTP) theksoi rëndësinë e institucioneve që organizojnë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve publike **që janë përgjegjëse dhe ndërmjet autoriteteve publike** dhe operatorëve (privatë). Ai paraqiti modele teorike dhe modele të vërteta që zbatohen në botë që tregojnë se si **"autoritetet organizuese"**

do të mund të luanin këtë rol. Por detyra e bashkërendimit është vetëm pjesërisht e plotësuar nëse ajo kufizohet në organizimin e shërbimeve të transportit publik. **Një integrim strategjik efikas duhet të përfshijë edhe transportin dhe planifikimin hapësinor.** Bashkërendimi ndërmjet planifikimit hapësinor dhe planifikimit të transportit është çështje e politikës urbane, mjedisore, ekonomike dhe shoqërore. Ramadan Duraku, Shef i seksionit të MTPT-së dhe Luan Nushi, Drejtor i Institutit të Planifikimit Hapësinor, paraqitën një numër mbresëlënës të studimeve të bëra kohëve të fundit, të cilat përfshinin elemente të rëndësishme për hartimin e politikës së transportit (analizën e qarkullimit në trafik, struktura e çmimeve, modelet organizative, skenarët e zhvillimit, etj). Muhamet Morina, nga departamenti i shërbimeve publike i qytetit të Prishtinës, sqaroi se si ishte zbatuar sistemi i parë i autobusëve urban pas luftës dhe se si ishte planifikuar të zhvillohej sistemi i transportit, sipas planit zhvillimor urban të Prishtinës. Por **politikat përbëhen nga zgjidhjet politike dhe strategjike.** Politik bërësit mund të vendosin që të presin që zhvillimi spontan të përcaktojë mënyrën e urbanizimit dhe t'ia lënë sektorit të transportit publik që të vendosi se a do t'i shërbejnë, kur dhe ku do t'i shërbejnë tregjet e reja. Në këtë rast, zhvillimi urban ka shumë mundësi që të bazohet në automjete. Politikat po ashtu mund të kenë parasysh se transporti publik është mënyra më efi-kase e transportit urban dhe se për këtë arsye, qasja në qytet dhe largësitë më të mëdha brenda qyteteve duhet të mbulohen nga mjetet e transportit publik. Për të arritur këtë, planet e zhvillimit urban duhet të përfshijnë rrjete të transportit publik me kapacitete të larta dhe të sigurojnë që zhvillimi urban dhe shpeshimi të bëhet përreth këtyre akteve të fuqishme të transportit publik. Frédy Wittwer, Drejtor i Institutit Ndërkombëtar për trajnime në mobilitet në Gjenevë, theksoi se investimet në korridoret e transportit publik janë vendime strategjike që duhet të marrin parasysh tërë shpenzimet e jashtme, d.m.th., aksidentet, ndotjen e ajrit, konsumimin e hapësirës publike.

(Vazhdon në faqen 11)

Vlerësimi afatgjatë duhet të marrë parasysh edhe rritjen e çmimeve të energjisë dhe efektet afatgjate të formës dhe infrastrukturës efikase urbane. Në këtë aspekt, Kosova tani mund të marr vendime të mërgura dhe me vendosmëri për të shmanjur rënien e vendit poshtë në rrugën e kushtueshme të varësisë nga automobilat. Dy komunat, Ferizaj dhe Peja, po përgatisin plane konkrete për të siguruar transportin publik. Komuna e Ferizajt ka vendosur që në të ardhmen të bazohet edhe në hekurudhën, dhe të vlerësojë situatën e saj të privilegjuar si stacion kryesor ndërmjet dy kryeqyteteve (Prishtinës dhe Shkupit). Në këtë perspektivë, është shumë me rëndësi që të sigurohet se qendra urbane të mbetet dhe zhvillohet përreth vendit ku është stacioni hekurudhor dhe që ky vend të ofrojë qasjen maksimale me të gjitha mjetet e transportit, që të sigurojë një hapësirë me cilësi më të madhe për punësim, shitore dhe objekte banimi dhe që hapësira publike në këtë zonë të jetë e këndshme dhe tërheqëse.

Mustafë Zariqi, shef i Seksionit të planifikimit në Komunën e Ferizajt, prezantoi konkursin për **dizajnin e qendrës së mobilitetit**, i cili u hap në nëntor 2007 dhe do të shpërblejë propozimet më të mira dhe që plotësojnë kushtet e konkursit.

Në Pejë është finalizuar Plani Zhvillimor Komunal (PZHK). Agron Sallova, këshilltar i MuSPP-së për planifikimi hapësinor, sqaroi se adresimi i sfidës së mobilitetit dhe transportit njihet si faktori kryesor për suksesin e zbatimit të tij. Nëse komuna nuk ia del që të kufizojë tollovinë e trafikut të shkaktuar nga automobilat dhe që të sigurojë qasje të lehtë në qendër të qytetit nga lagjet periferike dhe nga lokalitetet e tjera, shumë më shumë funksione urbane do të zhvendosen në periferi ose lokalitetet rurale, që pastaj do të nxisë banorët të largohen nga qyteti.

Krijimi i një rrjeti efikas të autobusëve të qytetit është një nga zgjidhjet e mundshme për këtë problem: një rrjet i linjave të autobusëve urban që puqen në qendrën e qytetit në intervale të rregullta dhe relativisht të shkurtra, me orar të përpiktë për të siguruar shërbime të besueshme dhe bartje të lehta. Kjo kërkon garantimin se autobusët nuk do të zihen në tollovi trafiku. Por strategjitë komunale të mbështetjes më të madhe dhe më solide në rrjetin ndërrurban të autobusëve dhe në hekurudhë për të pasur qasje nga lokalitetet e largëta mund të ketë sukses vetëm nëse komunat e tjera zhvillojnë të njëjtën strategji dhe nëse shërbimet e ofruara nga autobusët dhe hekurudha

evoluojnë për t'i shërbyer një trafiku gjithnjë e më të madh. Në lidhje me këtë, Xhevat Ramosaj, Drejtor menaxhues i Hekurudhave të Kosovës e ka prezantuar rinisjen e funksionimit të linjës hekurudhore të udhëtarëve Pejë – Prishtinë me 1 tetor 2007. Natyrisht, pjesa e tanishme e qarkullimit të përgjithshëm të kësaj linje të hapur rishtas që ende funksionon me vetëm dy njësi është shumë e vogël. Por fara për një sistem transporti modern, efikas, shumëmodelësh dhe të qëndrueshëm është mbjellë dhe do të rritet, nëse politikat e transportit dhe planifikimit hapësinor janë të vendosura për të vazhduar në këtë drejtim. Gjatë tërës ditës, diskutimet ndërmjet folësve dhe qytetarëve ishin shumë të gjalla. Shumica e intervenimeve treguan për rrezikun e mospërputhjeve ndërmjet teorisë së zhvillimit të qëndrueshëm të shfaqura nga ekspertët e planifikimit dhe transportit dhe realitetit të zhvillimit të bazuar në automobila, i cili është duke u zhvilluar në terren. Prandaj është urgjente që ekspertët e transportit dhe planifikimit hapësinor, administratat dhe vendimmarrësit të ndërmarrin me shpejtësi veprim më ambicioz për **planifikim të integruar hapësinor dhe të transportit** dhe të përdorin kompetencën dhe fuqinë e tyre për zbatimin sa më herët të themeleve të urbanizimit të qëndrueshëm në Kosovë.

MËNYRAT BASHKË-PRODUKTIVE PËR TË LIDHUR VIZIONIN ME PROJEKTET STRATEGJIKE URBANE

Shoqata ndërkombëtare e planerëve të qytetit dhe rajonal (ISOCARP) e mbajti kongresin e dytë botëror në Antwerp të Belgjikës në shtator, ku morën pjesë 356 delegatë nga 44 vende, nga të pesë kontinentet. Tema e kongresit ishte Trialogu urban – mënyrat bashkë-produktive për të lidhur paraqitjen e vizionit me projektet strategjike urbane – një temë shumë e rëndësishme e punës që është duke u kryer nga MuSPP/UN-HABITAT në Kosovë. Fjala 'dialog' është lojë me fjalën 'dialog', për të mbuluar bashkëveprimin e tri palëve ose elementeve. Qëllimi i një trialogu urban mund të jetë i ndryshëm, siç është bashkëveprimi ndërmjet komunitetit urban, qytetarëve dhe sektorit privat, por një përshkrim i rëndësishëm i paraqitur në kongres ka të bëjë me lidhjen ndërmjet tri elementeve të projekteve strategjike, qëndrueshmërisë dhe pjesëmarrjes. Duhet të bëhen këto lidhje në mënyrë që të arrihet një planifikim urban efikas.

Përcaktimi i vizionit (vizionimi) dhe planifikimi me bashkëpunim ishin temat kryesore dhe u theksua se përcaktimi i vizionit vjen si rezultat i negociimit – për të duhet të ketë konsensus. Aty u sugjerua që planerët duhet të kenë një ide ose 'para vizion' para se të hyjnë në debat me qytetarët, që planerët duhet të plani-

fikojnë por jo edhe të vendosin për qëllimet dhe objektivat. "Planifikimi nuk ka të bëjë me parashikimin e të ardhmes por me përgatitjen e të ardhmes" dhe projektet strategjike urbane mund t'i bëjnë të dukshme edhe vizionet abstrakte. U sugjerua që projektet duhet të fillojnë më herët gjatë zhvillimit të planit hapësinor, në mënyrë që në fazën e hershme të mblidhen informata dhe njohuri. Po ashtu është e rëndësishme që të theksohet se pjesëmarrja në planifikim krijon pritjet dhe kjo kërkon përkushtim, mendim kritik dhe veprim.

Çështjet kyçe në kongres përfshinin: çështjen se si të tejkalohen dallimet ndërmjet teorisë dhe praktikës, si të përdoren instrumentet e planifikimit dhe politikës, si të mundësohet pjesëmarrja e komuniteteve johomogjene dhe jo të bashkuara, si të trajtohet zhvillimi i vendbanimeve joformale, si të revitalizohen komunitetet rurale dhe si të ekuilibrohen hierarkitë ekonomike, mjedisore dhe shoqërore. U zhvillua një diskutim i gjatë në lidhje me mundësinë e qasjes së departamenteve të planifikimit në komunitet dhe niveli i bashkëveprimit të vërtetë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ndërmjet planerëve dhe qytetarëve.

Një çështje që u ngrit ishte se "sa duhet të përfshihen vet planerët në lagjen e tyre?" Kjo bëri që të mendohet se çka mund të nxitet në Kosovë për të përmirësuar në mënyrë më organike pjesëmarrjen në planifikim? Ndoshta planerët komunal duhet që çdo muaj të angazhohen në organizimin e takimeve joformale me qytetarët. Kjo mund të bëhet në formën e vizitave të rastit, me kafe (ndoshta edhe me tortë!), ku bashkëveprimi i lirë dhe shkëmbimi i njohurive mund të zhvillohen jashtë takimeve zyrtare publike ose takimeve komunale. Kjo mund të zgjerohet duke përfshirë teknologjitë e reja dhe bashkëveprimin virtual, me forume online (në internet) dhe me lajme të rregullta e të përditësuara online rreth çështjeve të planifikimit. Siç u tha në kongres, komunitetet e arsimuara janë esenciale për arritjen e stabilitetit dhe planerët duhet të jenë më pak teknokrat dhe më shumë të orientuar kah komuniteti për të ndihmuar që të sigurohet kjo. Shembja e pengesave dhe inkurajimi i një procesi të njëmendë gjithëpërfshirës të planifikimit do të shpie në mënyrë të sigurt në rezultate më të mira për qytetet e Kosovës.

*Për më shumë informata vizitoni:
www.isocarp.org*

VIZIONIMI I JUNIKUT

Juniku – është vërtetë unik.

Juniku—është vërtetë unik. Vend i traditës dhe Odave si institucione, Park etnografik i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, ruatja e së cilës do të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie për banorët e saj, me vend të merituar në ofertën rajonale në turizëm dhe integrim evropian.


Mbështetur nga CHwB-Trashëgimia kulturore pa kufij dhe UN-HABITAT-it nga data 17 deri më 22 tetor, në Ohër u mbajt punëtorja për "Vizionin e Junikut". Pjesëmarrës në punëtori ishin ekspertë të fushave të ndryshme, planerë, përfaqësues të komunitetit të biznesit, trashëgimisë kulturore nga Juniku dhe të shoqërisë civile.

Trashëgimia natyrore, kulturore dhe historike e komunës së Junikut e bëjnë atë një vend me karakteristika të veçanta. Kjo ishte pika fillestare që i motivoi pjesëmarrësit në punëtori për zhvillimin e një vizioni të qartë për komunën e Junikut. Vizioni për komunën e Junikut premtori një të ardhme më të mirë dhe një qasje më të lehtë në shërbimet zhvillimore.

Punëtorja filloi me një hartë nostalgjike, pasuar nga zgjedhja e çështjeve kryesore duke përfshirë: zhvillimin e turizmit, bashkëpunimin rajonal, zona urbane dhe e lagjeve, mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Diskutimet rreth analizës SWOT, objektivave dhe aktiviteteve të mbajtura gjatë punëtorisë u pasuan nga paraqitja grafike e vizionit në strukturën e planifikuar hapësinore për komunën e Junikut. Të gjithë pjesëmarrësit, si palë të rëndësishme të interesit në planifikimin gjithëpërfshirës të zhvillimit lokal, punuan së bashku dhe kontribuan në formulimin e vizionit për Junikun.

Juniku është një vend tradicional me një të kaluar të çmuar dhe me një të ardhme të ndritur dhe kjo porosi u sforcuua edhe më shumë në këtë punëtori. Si e tillë, Juniku dhe qytetarët e saj meritojnë një të ardhme më të mirë dhe përkushtimin e qeverisë lokale si dhe komunitetit që të kultivojë trashëgiminë natyrore duke përfshirë edhe trashëgiminë kulturore, për të mbrojtur dhe për ta bërë atë tërheqëse, jo vetëm për vizitorët por edhe për vet komunën.

Më 14 nëntor 2007, vizioni iu paraqit qytetarëve dhe mediave në një kullë të restauruar në Junik. Nga rezultatet e ar



ritura në këtë punëtori i kontribuan fillimit të fazës së parë të Planit Zhvillimor Urban i cili do të sigurojë bazën për një plan rregullues urban, si një prioritet për komunën dhe për këtë nevojitet bashkëpunimi me UN-HABITAT-in dhe CHwB-në.

Të dy këto meritojnë një falënderim të posaçëm për kontributin e dhënë në zhvillimin e vizionit të Junikut si një vend unik.

Shkodran Gaxherri

Nënkrjetar i Komunës së Junikut

ÇËSHTJET E PLANIFIKIMIT NË PILOT NJËSINË KOMUNALE HANI I ELEZIT

Në nëntor 2007, në Han të Elezit mbajt një punëtori treditore mbi çështjet e planifikimit hapësinor. Qëllimi i takimit ishte që ta njoftojë personelin dhe administratën e re të kësaj pilot njësie (PNJ) për sfidat e planifikimit komunal. Takimi i punës u organizua nga OSBE-ja dhe PNJ Hani i Elezit, përdorur ekspertët e MuSPP/UN-HABITAT-it ofruan mbështetje profesionale.

Në ditën e parë të punëtorisë eksperti planifikues komunal i MuSPP-së, Ismajl Baftijari, i prezantoi parimet ndërkombëtare në planifikimin urban dhe hapësinor. Pas kësaj u vazhdua me diskutimet e pjesëmarrësve. Në ditën e dytë të punëtorisë u bë një prezantim i çështjeve teknike dhe ligjore në lidhje me planifikimin hapësinor në Kosovë, prezantuar nga këshilltari ligjor i MuSPP-it, Lazim Salihu. Ky prezantim u pasua nga diskutimet dhe pyetjet rreth çështjeve të paracaktimit destinimit të pronës publike dhe përdorimit të saj.

Në ditën e dytë ishin kombinuar prezantimet për kornizën e zhvillimit hapësinor dhe për profilin komunal nga këshilltari planifikues komunal i MuSPP-së në Gjilan, Huig Deneef, dhe prezantimi i profilit të Hanit të Elezit nga Sami Stagova, shef i seksionit të planifikimit në Han të Elezit dhe koordinator i Grupit të ekspertëve të planifikimit.



U bë edhe një analizë SWOT për fushat e ndryshme të planifikimit, duke përfshirë: ekonominë, infrastrukturën, mobilitetin, banimin, çështjet shoqëro-kulturore, ekologjinë dhe bujqësinë. Grupet dolën me prezantime interesante.

Sesionet e ditës së tretë të punëtorisë ofruan informata mbi vizionin, parimet, qëllimet dhe kornizën zhvillimore. Pjesëmarrësit e vlerësuan lartë mundësinë që të përfitojnë përvoja derisa punojnë në grupe dhe i diskutuan këto tema, por edhe dëgjimi i përvojave të komunave të tjera në përgatitjen e planeve zhvillimore komunale

dhe urbane, dhe në mënyrë të veçantë procesin e krijimit të vizionit.

"Si përfundim, në emër të pjesëmarrësve, dua të falënderoj dhe tu shpreh vlerësimin e lartë ekspertëve të MuSPP/UN-HABITAT-it për mbështetjen në procesin e planifikimit hapësinor komunal. Ne presim të vazhdojmë edhe më tej këtë lloj bashkëpunimi."

Sami Stagova

Shef i Sektorit për planifikim dhe kordinator i grupit të ekspertëve të planifikimit në Han të Elezit

KËSHILLI EVROPIAN I PLANERËVE HAPËSINOR NË NIKOZI

Më 16-18 nëntor 2007 Këshilli Evropian i planerëve hapësinor (KEPH) mbajti takimin e Asamblesë së Përgjithshme në Nikozi të Qipros. KEPH-ja mbledh 26 shoqata dhe institute profesionale të planifikimit hapësinor nga 24 vende të Evropës. Ajo është shoqata ombrellë e cila iu ofron anëtarëve të saj një kornizë të përbashkët për praktikën e planifikimit, edukimit rreth planifikimit, vazhdimi i zhvillimit profesional dhe përkufizimin e përgjegjësisë profesionale (për më tepër informata shih <http://www.ceu-ectp.org>).

Takimit të KEPH-së në Nikozi i dëshiroj punë të suksesshme Ministri Greko-Qipriot i Punëve të Brendshme dhe Planifikimit Hapësinor. Ai e hapi seancën speciale rreth disa çështjeve të planifikimit hapësinor në Qipro që kanë rëndësi për Evropën. Phaedon Enitiades, këshilltar i planifikimit, i prezantoi rezultatet e Gardës Urbane, projekt i financuar nga BE-ja për të ndihmuar inkorporimin e treguesve të qëndrueshmërisë në procesin e planifikimit hapësinor në Qipro përmes një instrumenti të GIS (shih www.moi.gov.cy/moi/urbanguard/urbanguard.nsf/), Glafkos Constantinides, këshilltar i planifikimit, e paraqiti Master planin e Nikozisë, një iniciativë e përbashkët e të dy komuniteteve të qytetit të ndarë (Qipriot grek dhe turq), nën ombrellën e UNDP-së (lexoni më shumë në <http://www.undp-unops-pff.org/News.asp?CiD=97>). Ky prezantim dhe përvojë e qytetit të ndarë është i rëndësishëm për rastin e Mitrovicës. Vizita në qendrën e qytetit të ndarë Nikozia dhe në një kiosk informativ në master planin e Nikozisë ishte shumë e dobishme për të parë sfidat e mëdha të planifikimit në të dy anët.

Temat e tjera të diskutuara në takimin e KEPH-së ishin:

• Shoqata e Planerëve Rumunë u mirëprit si anëtare e re

• KEPH-ja do të organizojë konferencën "Pas Lajpcigut" (shih buletinin e fundit të MuSPP) në Londër, në fillim të vitit 2008

• KEPH-ja do të mbështesë organizimin e Bienales së ardhshme të planerëve të qyteteve më 2009 në Nans të Francës

• KEPH-ja do të organizojë një ceremoni për dhënie të Shpërblimeve për Planerët Evropian në vjeshtë të vitit 2008 në Dublin.

Sa i përket anëtarësisë të planerëve të Kosovës në të ardhmen, janë shikuar disa skenarë me kryetaren e re të zgjedhur, zj. Virna Bussadori. KEPH-ja është shumë e gatshme të mirëpret planerët e rinj nga shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor. Planerët serbë tashmë kanë fituar statusin e vëzhguesve dhe e njëjta gjë mund t'i ndodh edhe planerëve të Kosovës.

Miran Gajsek, nënkryetar i KEPH-së dhe kryetar i shoqatës së planerëve slovenë është emëruar si person kontaktues dhe mentor për planerët kosovarë. Miran Gajsek e njezh shumë mirë gjendjen në Kosovë dhe e ka pritur një delegacion të MuSPP-së për një vizitë studimore në Slloveni në vitin 2006.

VULLNETARIZMI NË MUSPP/UN-HABITAT-IN NË KOSOVË

Vullnetarizmi është pjesë e natyrshme dhe themelore e shumicës së shoqërive. Programi i vullnetarëve të OKB-së (UNV) evokon përfitimet që sjell angazhimi qytetar, integron vullnetarizmin në programet zhvillimore dhe çdo vit mobilizon

mijëra vullnetarë për dhënien e kontributeve të ndryshme për një zhvillim më efikas. Sot, UN-HABITAT/ MuSPP punëson 6 UNV ndërkombëtarë dhe 8 vendorë të cilët punojnë me përkushtim për të ndihmuar në përmirësimin e cilësisë dhe

kushteve të jetës në qytetet partnere në MuSPP. Motivimi dhe përvojat e katër vullnetarëve të OKB-së që punojnë me MuSPP janë përmbledhur në tekstin në vazhdim.

Retrospektiva nga një vullnetar i KB-së

Padyshim, unë nuk isha planeri i vetëm urban që kisha këtë ndjenjë. Kisha një diplomë dhe një punë të përshtatshme që më mundësoj të kuptoj si duhet funksionimin e një shteti dhe të një shoqërie. Unë isha si një hallkë në një sistem që funksiononte shumë mirë dhe pyeteshja nëse unë isha një person që ndryshonte gjërat. Pastaj e kuptova se ka mjaft rajone në botë ku kjo makineri nuk funksiononte edhe aq mirë dhe ku do të ishte e mirëseardhur puna e ekspertëve perëndimorë. Dhe mendova se mund të jetë vërtet gjë e mirë që të zgjerohet horizontet e mija dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë të tjerët. UN-HABITAT-i është një ndër organizatat të cilat më jepnin përgjigje në pyetjet e mija.

Përmes Programit të vullnetarëve të OKB-së, kjo organizatë ia doli që të punësojë ekspertët e duhur dhe të krijojë programe të mbështetjes së politikave për periudhat afatshkurtra dhe afatmesme me një buxhet mjaft të kufizuar. Aplikova në MuSPP dhe në verën e vitit 2006 erdha në Kosovë.

Personalisht, kur shikoj prapa në nëntëmbëdhjetë muajt e kaluar si vullnetar i KB-së në Pejë, ndjehem i kënaqur. Pas arritjes sime, u dashtë të kaloj disa kohë që të kuptoj gjërat. Unë e dija se problemet hapësinore në Kosovë janë krejt ndryshe nga ato në Belgjikë. Por përgjigjen në pyetjen se sa ndryshojnë ato e mora vetëm pasi punova dhe jetova për disa muaj në Pejë. Në administratë kishte pengesa të mëdha, por kolegët e mi vendorë dhanë maksimumin që të përfshijnë zyrtarët ko-

munalë në punën tonë. Dhe pasi përshtata pak synimet e mija personale, ja dola që të përfundojë misionin tim në tetor 2007 me ndjenjën e kënaqësisë. Jam i bindur se funksionimi dhe objektivat e disa zyrtarëve ishin ndikuar dhe përshtatur në mënyrë proaktive si rezultat i përpjekjeve të mija. Por edhe unë përfitova shumë nga kjo. Puna në kultura të ndryshme ishte një përvojë magjepsëse. Dhe u kënaqa pa masë në peizazhin e pakufishëm dhe të pabanuar të Bjeshkëve të Nemuna. Për më tepër, unë pata rastin që të vizitojë pjesën më të madhe të Ballkanit për të parë një varg kulturash dhe historish. Dhe unë tani jam i përgatitur që të kthehem sërish atje: Kosova dhe vendet përreth saj janë në listën time të destinacioneve për të kaluar pushimet!

Kobe Boussauw, Gent, Belgjikë

ish-vullnetar i KB-së në Pejë

Kjo është kontrata ime e parë si vullnetar vendor i KB-së (VVKB). Kur fillova punën, Programi i MuSPP-së në Gjakovë veç kishte filluar dhe mua mu dashtë që të zë hapin me shpejtësi. Të qenit pjesë e programit të VVKB-së do të thotë të marrësh pjesë në promovimin e vullnetarizmit.

Vullnetarizmi të sjellë një ndjenjë madhështore; unë mendoj se ky është edhe shpirti i kosovarëve. Nganjëherë, vërtetë ndjej se ajo që bëjmë ne është shumë pak duke pasur parasysh nevojat e mëdha të njerëzve, por gjithmonë unë i kujtoj fjalët e Nënës Terëzë "nganjëherë ne ndjehemi se ajo çka jemi duke bërë është si një pikë uji në oqean, por

oqeani do të ishte më i vogël pa atë pikë"; kjo fjalë më bënë që të kem besim dhe të vazhdojë të punoj me përkushtim edhe më të madh. Puna për MuSPP-në në Gjakovë më ka dhënë mundësinë që të mësojë më shumë se si ndërtohen partneriteti dhe bashkëpunimi me zyrtarët, shoqërinë civile, komunitetin dhe palët e rëndësishme me interes në proceset e zhvillimit hapësinor dhe urban.

Suksesi më i madh është se ne kemi rritur vetëdijen e njerëzve për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e planifikimit. Nganjëherë neve na duket se ajo çka jemi duke bërë është shumë pak në krahasim me nevojat shumë të mëdha të shoqërisë

sonë, por atë çka bëjmë duhet ta shohim si fillim i ndryshimit ose përmirësimit. Qytetarët e Gjakovës po bëhen të vetëdijshëm për faktin se shoqëria civile ka një rol të rëndësishëm që ta bëjë qytetin ku jetojmë një vend më të mirë për të jetuar. Sot më shumë se kurrë qytetarët e Gjakovës ndjejnë përgjegjësinë për të bashkëpunuar me qeveritë lokale në përmirësimin e cilësisë së jetës. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin planifikimit mund të përmirësohet vetëm përmes rritjes së vullnetarizmit. Prandaj, unë besoj se ne mund të bëjmë më shumë në këtë aspekt duke shfrytëzuar potencialin e vullnetarizmit.

Pren Domgjoni

VVKB në Gjakovë

Pas gjashtë muajsh si vullnetar vendor i KB-së (VVKB) në Kosovë, unë jam shumë i kënaqur të them se është nder dhe kënaqësi që të jem pjesë e një organizate të rëndësishme. Jam shumë i kënaqur me punën që bëj dhe me ekipin që punoj, ndonëse jam i vetëdijshëm se gjithmonë ka mundësi që të bëhet edhe më shumë dhe më mirë. Ndjenja e të ndihmuarit të njerëzve në kri-

jimin e një të ardhme më të mirë për qytetin e tyre është vërtetë kënaqësi e madhe dhe diçka që duhet ta përjetojë çdo person.

Puna jonë kërkon shumë energji, kohë, durim dhe motivim, por ndjenja se puna ime ka ndihmuar që të përmirësojë jetën e së paku një personi është shumë e mirë dhe asgjë tjetër nuk ka më rëndësi.

Nëse secili nga ne do t'i kushtonte së paku pesë minuta në ditë që të ndihmojë të tjerët, bota do të ishte një vend shumë më i mirë për të jetuar. Shpresoj që puna ime si VVKB do të vazhdojë në të ardhmen dhe unë do jap maksimumin që të përmbush qëllimet dhe misionin tonë, siç jam përpjekur të bëj edhe deri më tani.

Darko Djoric

MuSPP VKB në veri të Mitrovicës

VKB me MuSPP/UN-HABITAT-in: Planifikimi i punës

Si planer hapësinor unë i dua qytetet. Ato gjithmonë zhvillohen dhe ky zhvillim nuk përfundon kurrë. UN-HABITAT-i si agjenci e OKB-së e cila merret me qytetet dhe e cila ka mandatin që të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror dhe mjedisor të tyre, përmes MuSPP-së në Kosovë punëson vullnetarët e KB-së.

Unë kontribuoj si vullnetar në Pejë, një qytet mesatar përgjatë një lumi, i cili gjendet në buzë të maleve të larta. Ky është tani qyteti im dhe unë e dua atë! Kohëve të fundit u miratua Plani zhvillimor urban dhe janë përgatitur

shumë ide për zbatimin e këtij plani. Puna ime është që të ndihmojë komunën në funksionalizimin e planit të punës. Ka shumë sfida që plani synon t'i tejkalojë: të përmirësojë trafikun, të përmirësojë cilësinë e hapësirave publike, etj.

Viteve të fundit janë ndërtuar shumë objekte të reja. Ka investime, por ato duhet të orientohen dhe drejtohen. Ne si planerë e kemi për detyrë që të ndihmojmë në drejtimin e zhvillimit urban në drejtimin e duhur. Si vullnetarë unë përpiqem të jem afër njerëzve. Natyrisht unë do të sjellë përvojën time nga Holanda por edhe mund të mësojë shumë në Pejë. Së

paku, unë nuk jam këshilltar ndërkombëtar që kërkon pagesë të madhe për këtë punë. Puna si vullnetar është diçka e re për mua. Kjo më bën që të rimendojnë për etikën time të punës. Pse dua të kontribuoj në zhvillimin urban të Pejës? Për mua kjo ka të bëjë me ndërtimin e besimit dhe reciprocitetit ndërmjet njerëzve. Kështu që shpresoj se qyteti i Pejës më do mua po aq sa e dua unë këtë qytet.

Wouter van der Heijde

VKB Ndërkombëtar në Pejë

NËNNDARJA E TOKËS: ASPEKT I LËNË ANASH I ZHVILLIMIT TË TOKËS NË KOSOVË

“Shtëpitë e bëjnë qytetin (fizik), por qytetin e vërtetë e bëjnë qytetarët” (Zhan Zhak Ruso)

Peizazhi urban i Kosovës ka qenë gjithnjë i dominuar nga ngjyrat e tullave të reja. Lulëzimi i shpejtë i ndërtimeve është një ndër aspektet më të mrekullueshme të periudhës së pas konfliktit. Ndonëse të dhënat dhe shifrat e sakta janë gjithmonë të pakapshme, qytetet si Prishtina në mënyrë të qartë tregojnë se kohëve të fundit është intensifikuar procesi i zhvillimit urban të tokës. Ky proces ka marrë forma të ndryshme, duke filluar nga shfrytëzimet e pabazuara – të tokës së tyre private ose të tokës private të të tjerëve ose tokës në pronësi publike ose shoqërore – nga të varfrit dhe nga grupet shoqërore të pakicave siç janë “lagjet” Rome/Ashkali/Egjiptiane, deri te format më të konsoliduara të zhvillimit të tokës

të cilat krijojnë lagjet e klasës së mesme. Shumë, nëse jo shumica, e këtyre gjendjeve ka qenë rezultat i zhvillimit joformal (një proces që vështirë përkufizohet e që edhe më vështirë të parashikohen shifrat), për arsye se, në përmasa dhe në mënyra të ndryshme, nuk janë marrë parasysh dispozitat ligjore në fuqi, ose për shkak të problemeve ligjore me pronësinë mbi tokën, ose për shkak të mungesës së respektit për planifikimin urban dhe për rregulloret ndërtimore që janë në fuqi.

Nëse dëshirojmë që të parandalohet procesi gjithnjë në rritje i zhvillimit joformal në Kosovë në të ardhmen e afërt, është shumë me rëndësi që të zgjerohen kushtet e qasjes

në tokë të urbanizuar me shërbime, për të cilin proces rregullimi i nënndarjeve të ardhshme të tokës është me rëndësi shumë të madhe. Shumica e Kosovarëve tashmë kanë treguar se ata mund të ndërtojnë, dhe të ndërtojnë mirë, përmes mekanizmave të tyre socioekonomik; megjithatë, ndërtimet më të mira kërkojnë jo vetëm kushte më të specifikuara teknike, por rregullim më të mirë të procesit të zhvillimit të tokës që i përcakton ato, ato të nënndarjes së saj. Një analizë më e thellë e këtyre vendbanimeve joformale mund të merret drejtpërdrejt në: www.unhabitat-kosovo.org

Edesio Fernandes

Jurist dhe planer urban në MuSPP/UN-HABITAT

KËNDI I MEDIAVE

Në këndin e Mediave kemi zgjedhur disa tituj e citime interesante në lidhje me planifikimin urban dhe zhvillimet në Kosovë. Artikujt origjinalë mund t’iu dërgohen sipas kërkesës

GJILANI

“Gjilani 2005 – 2015”

Ky artikull ofron informacione rreth shqyrtimit publik të Planit zhvillimor komunal të komunës së Gjilanit. “Ky plan është shumë i avancuar dhe pozitiv”, tha Fadil Sherifi, ushtrues detyre i drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit, autoritetit përgjegjës për këtë projekt.

“Duke përdorur pozitën e tij qendrore në të trekëndësh të dyfishtë, Gjilani do të jetë urë moderne dhe do të ofrojë shërbime cilësore si mjedis të qëndrueshëm, edukim dinamik dhe teknologji moderne që e mbështet zhvillimin e ekonomik, e veçanërisht zhvillimin e bujqësisë”, tha Shkëlzen Qorraj, përfaqësues i kompanisë Intech, që e hartoi këtë plan. *Burimi Lajm, 27 nëntor 2007*

GJAKOVA

Ka përfunduar deklarata e vizionit për Gjakovën

Kuvendi Komunal i Gjakovës, i ndihmuar nga UN-HABITAT-i, e ka përfunduar deklaratën e vizionit për të ardhmen e Gjakovës. Në këtë deklaratë, Gjakova paraqitet si një vend i pasur me trashëgimi kulturore, historike dhe natyrore; qytet i lumenjve; kryeqytet i Malësisë së Gjakovës dhe si vend zhvillimit ekonomik dhe bujqësor; zonë e kalimit të lirë kufitar, e hapur për bashkëpunim me vendet fqinje dhe me botën, duke përdorur aeroportin e saj; qendër universitare në një mjedis specifik; një mjedis i shëndoshë dhe ekologjik, i cili mund të tërheqë investitorët e huaj; qytet me infrastrukturë moderne dhe me një ofertë të mirë për zhvillimin e turizmit, e integruar në rrjetin e zhvillimit evropian dhe e gatshme për të përballuar sfidat e tanishme.

Në formulimin e kësaj deklarate ka ndihmuar një cikël i përfaqësuesve të shoqërisë civile,

përfaqësuesit nga qeveria, komuniteti i biznesit dhe ekspertët në Gjakovë. “Ne duam t’ua japim këtë deklaratë të vizionit autoriteteve komunale me shpresë së ajo do të behët pjesë e Planit zhvillimor komunal dhe urban”, tha Ramush Hajdari, përfaqësues i UN-HABITAT-it në Gjakovë.

Burimi Lajm, 12 nëntor 2007

PRIZREN

Shoqëria civile mbështet hartimin e planit zhvillimor komunal

Ky artikull ofron informata për dokumentin e vizionit të integruar për komunën Prizrenit, i cili e mbështet përgatitjen e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). UN-HABITAT-i ka organizuar një punëtori me qëllim të integritetit të objektivave të paraqitur nga shoqëria civile për zhvillimin e Prizrenit në të ardhmen.

Këshilltari i UN-HABITAT-it, Frank Schwartze, që ishte moderator i takimit, sqaroi se punëtorja do të mundësojë përgatitjen e strategjisë, e cila është përgatitur me pjesëmarrjen e shoqërisë civile për tu përdorur gjatë përgatitjes së PZHK-së. Rezultatet nga punëtorja e theksojnë rëndësinë e mbrojtjes së qendrës historike, zgjerimit të zonës industriale; bërjen e hapësirave të banimit më pak të dendura dhe mbrojtjen e tokës bujqësore. *Burimi Koha Ditore, 23 dhjetor 2007*

PEJË

Fama e traditës

Peja ende njihet si qendër në të cilën biznesi është traditë familjare, që fëmijët e trashëgojnë nga prindërit. Por rënia e aktiviteteve të biznesit në Pejë vjen si pasojë e konkurrencës në rritje dhe e rënies së fuqisë blerëse. Komuna është duke kërkuar variante për zhvillimin e një zone për zhvillimin e bizneseve, ku bizneset e vogla dhe të mesme do të gjenin kushte të mira pa ndikuar negativisht në mjedisin urban. Kjo zonë mund të krijohet përgjatë rrugës

Pejë-Deçan, afër bazës së KFOR-it italian. *Burimi Koha Ditore, 30 tetor 2007*

FERIZAJ

Many needs, lack of money

Ky artikull jep informata për projektet e reja kryesore në të cilat duhet të investohet në vitin 2008 në Ferizaj. Investimet më të mëdha do të bëhen kryesisht në infrastrukturë. Projekti më kapital do të jetë një investim prej 800 000 Eurosh në rrjetin e sistemit të ujësjellësit për disa pjesë të qytetit duke përfshirë edhe dhjetë fshatra. Mbi 533 000 euro janë parashikuar për ndërtimin e shkollave, ndërsa 400 000 euro për përshtatjen e sistemit të kanalizimit, kryesisht në fshatra.

“Për dallim nga vitet e mëparshme, ketë herë bordi i drejtorëve i ka ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës një listë të madhe të projekteve për vitin 2008, e cila përfshinë një shumë prej mbi shtatë milionë eurosh. Duke pasur parasysh mundësitë e tanishme, Komiteti ka zgjedhur projektet më urgjente për t’i zbatuar në vitin 2008. Qytetarët nuk do të marrin pjesë në të gjitha projektet e investimeve, por vetëm në ato të cilat ka vendosur Kuvendi Komunal”, tha Dukagjin Hetemi, ish Kryeshef Ekzekutiv i Komunës së Ferizajit. *Burimi Lajm, 27 nëntor 2007*

MITROVICË

Janë hequr 30 kiosqe

Ky artikull paraqet informata rreth veprimtimit të ndërmarrë nga Kuvendi Komunal në Mitrovicë për heqjen e kiosqeve nga tregu i vjetër dhe për t’i zhvendosur ato në tregun e ri.

Hapësira e tregut të vjetër, me përjashtim të pjesës që i është dedikuar për tregun e gjelbër, do të shndërrohet në hapësirë të gjelbër sipas planit të ri të zhvillimit urban. *Burimi Lajm, 22 tetor 2007*



World Urban Forum 4
第四届世界城市论坛
13-17 October 2008 Nanjing, China

FIRST ANNOUNCEMENT
www.unhabitat.org/wuf

The Fourth Session of the World Urban Forum
**Harmonious Urbanization:
The Challenge of Balanced Territorial Development**

UN-HABITAT and the government of China welcome you to the fourth session of the world urban forum at the Nanjing Convention and Exhibition Centre, 13-17 October 2008. Held every two years, the Forum is the world's premier conference on cities and the problems they face in a world where half of humanity is urbanised – in the process of becoming urban.

Situated in the lower reaches of the Yangtze River, the ancient Chinese city of Nanjing dates back more than 2600 years and is known as the ancient capital of the six dynasties of China. It is home to almost 4 million people, a population which is rapidly expanding, propelled by a dynamic local economy. Nanjing and UN-HABITAT welcome you to the fourth session of the world Urban Forum, October 13-17, 2008 at the Nanjing Convention and Exhibition Centre.

Shpallje:

Urbanizimi i harmonizuar

Sfida e zhvillimit të balancuar territorial

UN-HABITAT-i dhe qeveria e Kinës iu mirëpresin në seancën e katërt të Forumit Botëror Urban në Konventën e Nanjingut dhe në Qendrën e ekspozitës, 13-17 tetor 2008. Forumi, që mbahet çdo dy vjet, është konferenca më e lartë botërore për qytetet dhe për problemet me të cilat ato përballen në botë, ku gjysma e njerëzimit është e urbanizuar – në epokën e re të homo urbanes (njeriu i urbanizuar).

I shtrirë në nivel të ulët pranë Lumit Jangce, qyteti antik kinez i Nanjing-ut është themeluar para më shumë se 2000 vitesh dhe njihet si kryeqytet antik i gjashtë dinastive të Kinës. Në të banojnë afër 4 milionë njerëz, popullsia e cila është duke u rritur me shpejtësi, e nxitur nga ekonomia lokale dinamike. Nanjing-u dhe UN-HABITAT-i iu mirëpresin në seancën e katërt të Forumit Botëror Urban, prej 13 deri më 17 tetor 2008 në Konventën dhe qendrën e ekspozitave të Nanjing-ut.

Forum Botëror Urban mbahet çdo dy vjet. Ky forum u krijua nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për studimin e urbanizimit të shpejtë dhe ndikimi i tij në komunitete, qytete, ekonomi dhe politika.

Më shumë informata mund të gjinden në www.unhabitat.org

BASHKË BËJMË QYTETE MË TË MIRA

Për të siguruar një jetë më të mirë për gjithë qytetarët, Kosova ka nevojë për qytete më të mira. Kjo mund të arrihet vetëm përmes planifikimit dhe punës së përbashkët. "Bashkë krijojmë qytete më të mira" është motoja e Programit të Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal, financuar nga SIDA, përmes të cilit UN-HABITAT-i do të mbështesë planifikimin komunal hapësinor në Kosovë. Planet duhet të jenë strategjike dhe të orientuara në veprime, detaje në planet rregullative urbane dhe të zbatuara me investime private e publike. Gjashtë qytetet sekondare të Kosovës – Peja, Gjakova, Prizreni, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjilani – mund të kontribuojnë në një zhvillim më të zhvillim më të Kosovës dhe të zvogëlojnë migrimet e vazhdueshme të popullsisë drejt kryeqytetit, Prishtinës. Përmes integritit në rrjetin urban evropian, qytetet dhe qytetarët e Kosovës do të lidhen me qytete tjera evropiane. Kjo mund të arrihet duke tërhequr investimet në zhvillimin e qëndrueshëm urban dhe duke përmirësuar qasjen për të gjithë. Investimet private janë të nevojshme për t'u kombinuar me ato publike, drejt sigurimit të shërbimeve më të mira për qytetarët: banim të përshtatshëm social, spitale, shkolla, transport publik, rrugë, si dhe përfundimisht, por jo më pak e rëndësishme, hapësirat atraktive publike për t'i kënaqur nevojat e një shoqërie në ndryshim.

IMPRESSUM



UN-HABITAT



Sida

Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal në Kosovë

Udhëheqëse e Zyres
Elisabeth Belpaire
office@unhabitat-kosovo.org

Zyra:
UN-HABITAT Kosovë
Rr: Nazim Gafurri, Nr. 33,
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381/38/517835
Fax: +381/38/517836

Informimi & Komunikimi/MP
Lumnije Gashi
lumnije.gashi@unhabitat-kosovo.org

Për më shumë informata:
UN-HABITAT/MuSPP

Ky Buletin është mundësuar nga Qeveria e Suedisë përmes SIDA-s. Gjitha vështrimet, mendimet dhe konkludimet i përkasin autorëve. Artikujt pa tregim autori janë pjesë e ekipit të MuSPP-it. Kontributet në lidhje me komunat jo domosdoshmërisht reflektojnë pozitën dhe vendimet e komunave në fjalë. Përmbajtja e këtyre artikujve jo domosdoshmërisht reflektojnë: Qëndrimin e UN-HABITAT-it ndaj çështjeve të ngritura apo deklaratave të bëra, si dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë vështrimet e SIDA-s, apo Qeverisë së Suedisë.